

KONTRATE DHURIMI E KUOTAVE TE SHOQERISE “DEDOLLI 2015” SH.P.K

Sot me daten 11 /10 /2019, ne palët kemi redaktuar kontraten e dhurimit te kuotave te kapitalit themeltare te shoqerise “DEDOLLI 2015” sh.p.k si me poshte vijon:

NENI 1 PALA DHURUESE

Znj. ESMERALDA DEDOLLI, shtetase shqiptare, e bija e Sabri, lindur ne Klos, Mat, me 18/09/1990 dhe banuese në Klos, Sheshi “Ahmet Zogu”, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per identitetin e te cilit u binda sipas pasaportës biometrike që më paraqiti me Nr. BF1349953.

NENI 2 PALA PRANUESE E DHURIMIT

Z. ERVIST DEDOLLI, shtetas shqiptar, i biri i Sabri, lindur ne Klos, Burrel, me 13/07/1992 dhe banues ne Tiranë, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per identitetin e te cilit u binda sipas leternjoftimit vetjak qe me paraqiti me nr. Personal J20713008A.

NENI 3 BAZA LIGJORE

1. Kjo kontrate hartohet ne baze dhe per zbatim te vullnetit te lire dhe te pavesuar te paleve percaktuar ne nenin 1 dhe nenin 2 si mesiper.
2. Kjo kontrate hartohet edhe ne baze dhe per zbatim te:
 - a) Statutit te shoqerise “DEDOLLI 2015” SH.P.K;
 - b) Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ne vecanti neni 73 dhe vijues te tij;
 - c) Vendimit te Asambles se Ortakut të vetëm te Shoqerise “DEDOLLI 2015” SH.P.K me Nr. 1, date 11 /10 /2019.

NENI 4 OBJEKTI

1. Kjo kontrate ka per objekt dhurimin e 1 kuote qe perben 100% te vleres se kapitalit themeltar, qe zoteron pala dhuruese **Znj. ESMERALDA DEDOLLI** ne kapitalin e shoqerise “DEDOLLI 2015” SH.P.K, qe jane prone e pales dhuruese dhe te te gjitha te drejtave qe lidhen me to.
2. Pala pranuese e dhurimit **Z. ERVIST DEDOLLI**, i pranon pales dhuruese **Znj. ESMERALDA DEDOLLI** 100 % (njëqind per qind) te kotave te kapitalit te saj, ne shoqerine “DEDOLLI 2015” SH.P.K

NENI 5 DETYRIMET E PALEVE

1. Detyrimet e pales shitesese:

- a) Marr persiper dhe deklaroj se jam pronar 100 % te kuotave ne shoqerin “DEDOLLI 2015” sh.p.k, dhe nga keto kuota i dhuroj 100 %, korresponduese te 1 kuote te kapitalit ne pronesine



time.

- b) Garantoj palen pranuese te dhurimit, se keto kuota jane te lira nga çdo barresim dhe detyrim karshi te treteve dhe per çdo pretendim qe mund te ngrene te tretet per cenimin e te drejtese se pronesise se pales pranuese te dhurimit (eviksjon), une jam i gatshem dhe i detyruar te paraqitem menjehere me kerkesen e pales pranuese te dhurimit dhe te cdo personi tjetet te trete, qe pretendon mbi keto kuota, para gjithë organeve gjyësore dhe administrative per te mbrojtur te drejtën e tij, si pronar i ligjshëm i ketyre kuotave pas nenshkrimit te kesaj kontrate.

2. Detyrimet e pales pranuese te dhurimit:

- a) Pala pranuese ka marre ne dorzim kuotat, duke mos patur asnje verejtje sipas dokumentit ligjor.

3. Detyrimet dy paleshe:

- a. Palet kontraktuese deklarojne se te gjitha detyrimet e pershkruara me lart dhe te gjitha ato qe burojne nga kjo kontrate dhurimi jane realizuar prej tyre dhe ata nuk kane asnje detyrim te ndersjellte midis tyre.
- b. Palet kontratuese deklarojne se kuotat jane marre ne dorëzim nga pala pranuese te dhurimit ne gjendjen ekzistuese dhe ata nuk ka asnje pretendim ne lidhje me kete veprim.

NENI 6

PASOJAT TRANZOTORE TE KALIMIT TE AKSIONEVE

1. Pala dhuruese si dhe pala pranuese jane solidarisht pergjegjes ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zotërimi i kuotave objekt i kesaj kontrate.
2. Pergjegjesia solidare e pales dhuruese dhe pales pranuese ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zotërimi i kuotave objekt i kesaj kontrate fillon nga çasti i kalimit te kuotave nepermjet nenshkrimit te kesaj kontrate dhe perfundon me regjistrimin e ketij kalimi ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar.

NENI 8

EFEKTET E KONTRATES

1. Kalimi i pronesise se aksioneve nga pala dhuruese tek pala pranuese ne perputhje me percaktimet e kesaj kontrate perfundon me regjistrimin e kesaj kontrata prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me percaktimet e ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar.
2. Kalimi i aksioneve sipas kesaj kontrate regjistrohet ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar.
3. Regjistrim i percaktuar ne piken 2 te ketij neni ka efekt deklarativ.

NENI 9

DOKUMENTET E BASHKELIDHURA

1. Kësaj kontrate i bashkëlidhen dhe konsiderohen si pjesë e pandashme dokumentet si më poshtë vijon:
 - a) Vendimi i Asamblese se Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "DEDOLLI 2015" sh.p.k, Nr. 1,

date 11/10/2019.

b) Dokumenti identifikues i paleve .

**NENI 11
DISPOZITA E FUNDIT**

1. Keshtu me firmosjen e kesaj kontrate nga ne palet kontratuese, pala dhuruese zonja **ESMERALDA DEDOLLI**, zhvishet nga pronesia e 100 % te kapitalit te shoqerise dhe pronar i vetem i tyre behet zoti **ERVIST DEDOLLI**, duke gezuar te gjithe te drejtat ligjore mbi keto kuota ne shoqerine, "**DEDOLLI 2015**" sh.p.k.
2. **Z. ERVIST DEDOLLI**, behet ortak i vetem i shoqerise "**DEDOLLI 2015**" sh.p.k. me 1 kuote te barazvlefshme me 100 % te kapitalit te shoqerise.
3. Ne Palet deklarojme se jemi dakord per kryerjen e regjistrimit te ketij akti ne QKB sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi.
4. Ne Palët e nënshkruajmë aktin me vullnetin tonë te lire dhe te plotë.

PALET KONTRATUESE

PALA DHURUESE

Znj. ESMERALDA DEDOLLI

Esmeralda Dedolli



PALA PRANNUESE

Z. ERVIST DEDOLLI

Ervist Dedolli

